

LIGJ PËR VEPRIMTARI HOTELIERE

TEKST I KONSOLIDUAR ¹

**Teksti në
gjuhën
Maqedonase**
Закон за
угостителската
дејност

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë hoteliere.

Neni 2

Veprimtari hoteliere është dhënia e shërbimeve hoteliere për vendosje dhe shërbime hoteliere për ushqim.

Neni 3

Shërbime hoteliere janë: përgatitja dhe shërbimi i ushqimit, përgatitja e racioneve për shkak të konsumimit në vend tjetër, shërbimi i pijeve alkoolike dhe joalkoolike, përgatitja dhe shërbimi i pijeve të nxehta dhe të ftohta dhe kryerja e veprimeve për vendosje.

II. KRYERËSIT E VEPRIMTARISË HOTELIERE

Neni 4

Veprimtari hoteliere mund të kryejnë shoqëritë tregtare dhe tregtarët individë të regjistruar në regjistrin tregtar (në tekstin e mëtejme: hotelierë).

Personat fizikë, të cilët në pajtim me dispozitat e këtij ligji kryejnë veprimtari hoteliere prej regjistrohen në regjistrin që e mban prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit. ²

Formën dhe përmbajtjen, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi 2 të këtij neni, e përcakton ministri kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë.

Neni 4-a

Personat fizikë të cilët në përputhje me dispozitat e këtij ligji kryejnë veprimtari hoteliere, parashatrojnë kërkesë për regjistrim në regjistër të kryetari i komunës, kurse në qytetin e Shkupit të kryetari i komunës në territorin e qytetit të Shkupit.

Me kërkesën nga paragrafi i 1 dorëzohet:

- fletëparaqitje te Inspektorati Shtetëror i Tregut për përmbushjen e kushteve minimale-teknike;
- dëshmi për pronësi në rast se bëhet fjalë për persona fizikë të cilët kryejnë shërbime hoteliere për vendosje në shtëpi, në apartamente dhe dhoma,
- dëshmi për pronësi ose dëshmi për të drejtën e shfrytëzimit, në rast se bëhet fjalë për ekonomi familjare fshatare ku jepen shërbime për dhënie e dhomave dhe apartamenteve dhe
- dëshmi për taksë të paguar administrative, në shumë prej 50 denarësh.

Personat fizikë nga komunat, nga komunat në qytetin e Shkupit dhe nga qyteti i Shkupi, që e mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditë pune nga parashtrimi i kërkesës.

Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga fusha e hotelerisë.

Neni 4-b

Kryetari i komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit, kryetari i komunës së territorit të qytetit të Shkupit, brenda afatit prej tetë ditësh, prej ditës së pranimit të kërkesës nga neni 4-a paragrafi 1 i këtij ligji, lëshon aktvendim për regjistrim në regjistrin.

Kryetari i komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit, kryetari i komunës së territorit të qytetit të Shkupit, brenda afatit prej tetë ditësh, prej ditës së pranimit të kërkesës nga neni 4-a paragrafi 1 i këtij ligji, lëshon aktvendim për refuzimin e kërkesës për regjistrim në regjistër, në rast se kërkesa është e pakompletuar.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të aktvendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga fusha e hotelerisë.

Neni 4-v

Personat fizikë që janë regjistruar në regjistrin nga neni 4-a i këtij ligji, brenda afatit prej 15 ditësh, prej ditës së pushimit të kryerjes së veprimtarisë për të cilën janë regjistruar, parashtrojnë kërkesë për pushimin e vlefshmërisë së aktvendimit për regjistrim në regjistër.

Me kërkesën nga paragrafi i 1 i këtij neni i dorëzohet:

- aktvendim për regjistrim në regjistrin e personave fizikë të cilët kryejnë veprimtari hoteliere dhe
- dëshmi për taksë të paguar administrative, në shumë prej 50 denarësh.

Personat e autorizuar nga komuna, ndërsa në qytetin e Shkupit nga komunat në qytetin e Shkupit, i cili mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 alineja 1 të këtij neni, nga evidenca personale, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.

Kryetari i komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit, kryetari i komunës së territorit të qytetit të Shkupit, në bazë të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij

neni, brenda afatit prej tetë ditësh, lëshon aktvendim për pushimin e vlefshmërisë së aktvendimit për regjistrimin e personit fizik në regjistër.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga fusha e hotelerisë.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të aktvendimit nga paragrafi 4 i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga fusha e hotelerisë.

Neni 5

Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me dhënien e shërbimeve për ushqim dhe vendosje në objekte personale të personave juridikë, të cilët organizojnë ushqim dhe vendosje për të punësuarit e tyre, institucionet edukative-arsimore, edukative - përmirësuese, sociale, shëndetësore dhe institucione tjera, si dhe në objektet për ushqim dhe vendosje të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mbrojtjes dhe njësive të tjera të mbrojtjes, objektet për ushqim dhe vendosje të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i punëve të brendshme dhe institucioneve tjera publike administrative.

Neni 5-a

Personat fizikë dhe juridikë nga fusha e hotelerisë me qëllim të përparimit të veprimtarisë mund të bashkohen në forma të ndryshme të bashkimit në pajtim me ligjin.

III. KUSHTET DHE MËNYRA E KRYERJES SË VEPRIMTARISË HOTELIERE

1. KUSHTET PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË

Neni 6

Për kryerjen e veprimtarisë hoteliere doemos duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara minimale-teknike.

Përveç kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, doemos të përmbushen edhe kushtet vijuese: objekti të mund të përdoret, kushtet sanitare shëndetësore, kushtet për mbrojtje gjatë punës, mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor, mbrojtja kundër zjarrit dhe kushtet për mbrojtje nga zhurma të përcaktuara me ligj.

Veprimtaria hoteliere në objektet hoteliere në bar nate, kabare, disko-klub dhe disko-klub në sipërfaqe të hapur mund të kryhet nëse hotelieri siguron pëlqim nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i punëve të brendshme se janë plotësuar kushtet për mbrojtje të rendit publik dhe qetësisë dhe sigurisë në komunikacion.

Neni 7

Hotelieri është i detyruar që përmbushjen e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji dhe fillimin me punë t'ia paraqesë Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit kryetarit të

Komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit në bazë të vendit dhe selisë të objektit, gjegjësisht në bazë të vendit ku jepen shërbimet, më së paku 15 ditë para fillimit me punë të objektit hotelier.

Hotelieri është i detyruar t'ia paraqesë edhe ndryshimin e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, kryetarit të Komunës në rajonin e qytetit të Shkupit në bazë të vendit dhe selisë të objektit, gjegjësisht në bazë të vendit ku jepen shërbimet, në afat prej 15 ditëve nga ndryshimet e bëra.

Ministri i Ekonomisë e rregullon formën dhe përmbajtjen e formularit të fletëparaqitjes nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 8

Prefekti i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit prefekti i komunës në rajonin në Qytetit të Shkupit, mban evidencë të hotelierëve të cilët fillojnë me punë në rajonin e tyre.

Prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit e informon prefektin e Qytetit të Shkupit për regjistrimin e kryer personave fizikë në regjistër në kuptim të nenit 4 paragrafi 2 i këtij ligji, si dhe për paraqitjen e hotelierëve, të cilët fillojnë me punë në rajonin e tyre në kuptim të paragrafit 1 i këtij neni.

Neni 9

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë, i përcakton kushtet minimale-teknike të objekteve për kryerjen e veprimtarisë hoteliere, si dhe kushtet për kategorizim për kryerjen e veprimtarisë hoteliere.

Neni 10

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë, përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit për mënyrën e mbajtjes së evidencës nga neni 8 paragrafi 1 i këtij ligji.

2. LËNDA DHE MËNYRA E PUNËS SË HOTELIERËVE

Neni 11

Hotelierët e kryejnë veprimtarinë hoteliere në pajtim me këtë ligj, si dhe me zakonet e posaçme të hotelerisë dhe traditave të tjera afariste në hotelieri, dhe varësisht nga llojet dhe mënyra e ofrimit të kushteve hoteliere në lloje përkatëse të objekteve afariste.

Neni 12

Veprimtaria hoteliere mund të kryhet në objekte afariste, apo lokale në objekte afariste banesore dhe banesore afariste, të rregulluara dhe pajisura për të ofruar shërbime hoteliere, nëse janë plotësuar kushtet për kryerjen e aktiviteteve hoteliere të përcaktuara me këtë ligj.

Veprimtaria hoteliere mund të kryhet edhe në objekte apo lokale ku kryhet veprimtari tjetër, nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara për kryerjen e veprimtarisë hoteliere.

Veprimtaria hoteliere mund të kryhet edhe jashtë objektit afarist në lokalin dedikuar, rregulluar dhe të pajisur për dhënien e shërbimeve hoteliere, në bazë lejes së dhënë nga prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit nga prefekti i Qytetit të Shkupit.

Veprimtaria hoteliere në objektet hoteliere - bar nate, kabare dhe disko-klub, nuk mund të kryhet në lokal afarist, i cili gjendet në ndërtesë kolektive për banim.

Objektet hoteliere për ushqim, në përbërje të objekteve hoteliere për vendosje, janë ato objekte të cilat në mënyrë ndërtimore dhe funksionale u takojnë personave fizikë dhe juridikë, të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë hoteliere.

Për kryerjen e veprimtarisë hoteliere në objektet për ushqim, doemos duhet të ketë person të punësuar me së paku përgatitje të mesme profesionale nga lëmi i hotelerisë.

Neni 13

I fshirë 3

Neni 14

I fshirë

Neni 15

Në objektet hoteliere të tipit të mbyllur në institucionet edukative-arsimore, arsimore, edukative-përmirësuese, sociale, shëndetësore dhe institucioneve të tjera të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë, në objektet e administratës publike, objektet për ushqimin e të punësuarve të personave juridikë, nuk mund të shërbehet alkool dhe pije alkoolike.

3. EMRI DHE LLOJET E OBJEKTEVE HOTELIERE

Neni 16

Objektet hoteliere mund të jenë:

- 1) objekte hoteliere për vendosje; dhe
- 2) objekte hoteliere për ushqim.

Neni 17

Emri i objektit hotelier caktohet sipas llojit të shërbimeve hoteliere, të cilat kryesisht jepen në atë objekt.

Objektet hoteliere sipas llojit të shërbimeve hoteliere, kanë emër në pajtim me Klasifikimin nacional të veprimtarive.

Emri i llojit të objektit hotelier mund të ndryshojë, nëse janë plotësuar kushtet, të cilat janë përcaktuar për dhënien e llojeve të tjera të

shërbimeve në objektin hotelier.

Emri dhe përmbajtja e llojit të objektit hotelier nga neni 16 i këtij ligji, i përcakton ministri i cili menaxhon me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 18

Objektet hoteliere për vendosje ndahen në:

- 1) objekte themelore hoteliere për vendosje, në të cilat marrin pjesë hotelet, vendbanimet hoteliere, vendbanimet me apartamentet, motelet, pansionet, rezidencat, vendbanimet turistike dhe ngjashëm; dhe
- 2) objektet komplementare për vendosje, ku marrin pjesë: bujtinat, hanet, kampet, kapacitetet private për vendosje (dhomat, apartamentet, banesat, shtëpitë), pushimore (për fëmijë, të rinj, punëtorë, persona me pengesa dhe ngjashëm), objektet e mbetura komplementare (shtëpitë feriale, shtëpitë malore dhe të gjuetisë dhe shtëpitë, objektet për vendosje të përkohshme dhe ngjashëm).

Neni 19

Objektet hoteliere për ushqim mund të jenë:

- 1) restorantet (hanet, restorantet për vetëshërbim, ekspres restorante, qoshqe, restorante qumështi, restorante kopshte, kopshte verore, qebaptore, lokale të hapura, piceri, objekte për ushqim të shpejtë dhe ngjashëm);
- 2) baret (kafene, kafiteri, bar nate, kafe bar, kabare, disko-klub, disko-klub në sipërfaqe të hapur, birrari dhe ngjashëm);
- 3) restorant nacional-mejhane;
- 4) kantinat, dhe
- 5) objektet të tjera hoteliere për ushqim.

Në objektet hoteliere nga paragrafi 1 i këtij neni doemos duhet të ketë person të punësuar me përgatitje profesionale nga lëmi i hotelerisë.

Neni 19-a

Për objektin hotelier për ushqim restorant nacional-mejhane, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë lëshon shenjë të posaçme.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të shenjës, nga paragrafi 1 i këtij neni.

Që të mund ta marrë shenjën nga paragrafi 1 i këtij neni, objekti hotelier duhet t'i plotësoj këto kritere:

- 1) kategorizim të realizuar në pajtim me nenin 27 i këtij ligji, me afat të pa kaluar të vlefshmërisë;
- 2) oferta për ushqim në listat për ushqim, duhet të jetë në proporcion prej së paku 70% ushqime vendase tradicionale në krahasim me ushqimet internacionale, ndërsa oferta e verës dhe pijeve tjera duhet të jetë në proporcion prej së paku 80% verëra dhe pije të tjera të prodhuara në Republikën e Maqedonisë në krahasim me verëra internacionale dhe pije tjera;
- 3) gjatë rregullimit të jashtëm dhe të brendshëm të objektit hotelier, të përdoren materiale natyrore, si dhe motive nga kultura vendase tradicionale, instrumente popullore, veshje, orendi-enë dhe të ngjashme;
- 4) veshja e personelit duhet të ketë aplikacione dhe motive nga tradita dhe

5) muzika që do të realizohet në objektin hotelier duhet të jetë burimore me tingull akustik.

Shenja nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të bartet.

Mënyrën dhe kriteret më të përafërta për marrjen e shenjës nga paragrafi 1 i këtij neni i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili menaxhon me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 19-b

Procedurën për marrje të shenjës nga neni 19-a e zbaton Komisioni për zbatim të procedurës për marrje të shenjës restorant nacional-mejhane (në tekstin e mëtejme: Komisioni) i përbërë nga pesë anëtarë, që kanë zëvendës.

Komisionin e formon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë dhe është i përbërë nga një anëtar i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë, një anëtar nga Ministria e Kulturës, një anëtar nga Kabineti i Zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i ngarkuar për çështje ekonomike dhe për koordinim me resurse ekonomike, një anëtar nga dhomat turistike dhe një anëtar nga ekonomia hotelierike.

Anëtari i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë në Komision është edhe kryetar i Komisionit.

Për procedurën e zbatuar Komisioni përpilon aktvendim në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse janë plotësuar kriteret të përcaktuara në pajtim me nenin 19-a të këtij ligji.

Aktvendimi nga paragrafi 4 të këtij neni jepet me vlefshmëri prej tre vjetësh.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 4 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë.

Shpenzimet për marrjen e shenjës nga neni 19-a paragrafi 1 të këtij ligji i bart hotelieri.

Lartësinë e shpenzimeve nga paragrafi 7 i këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë, në bazë të shpenzimeve të bëra reale për punën e Komisionit dhe përpilimin e aktvendimit. Shpenzimet nga paragrafi 7 të këtij neni paguhen në llogarinë e të hyrave personale të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 19-v

Për marrjen e shenjës nga neni 19-a paragrafi 1 i këtij ligji, hotelieri parashtron kërkesë në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, i bashkëngjitet:

- 1) aktvendim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë dhe
- 2) aktvendim për kategorizim të realizuar.

Personi fizik nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë, që mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 i këtij neni, nga organi kompetent publik, ne afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.

Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 19-g

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë mban Regjistër për restorantet nacionale-mejhane.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të restoranteve nacionale-mejhane.

Neni 19-d

Shenja nga neni 19-a paragrafi 1 i këtij ligji, hiqet me aktvendim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë, në raste kur bartësi i shenjës pushon t'i plotësojë kriteret të përcaktuara me këtë ligj.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë.

Neni 20

Veprimtaria hoteliere në bar nate, kabare, disko-klub dhe disko-klub në sipërfaqe të hapur, kryhet në bazë të licencës.

Hotelet me së paku katër yje mund ta kryejnë veprimtarinë nga paragrafi 1 i këtij neni pa licencë.

Licencën nga paragrafi 1 të këtij neni e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për punët në lëmin e hotelerisë.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë, përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës, si dhe mënyrën e dhënies dhe marrjes së licencës.

Neni 21

Për marrjen e licencës nga neni 20 paragrafi 1 i këtij ligji, hotelieri është i obliguar të parashtrorë kërkesë për lëshimin e licencës në formular për kompensim të paguar në Ministrinë e Ekonomisë për të ofruar shërbime për:

- kabare - në kundërvlerë me denarë prej 2.500 deri në 5.000 euro;
- bar nate - në kundërvlerë me denarë prej 5.000 deri në 7.000 euro, dhe
- disko-klub dhe disko-klub në sipërfaqe të hapur - në kundërvlerë me denarë prej 7.000 deri në 10.000 euro.

Me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohet dokumentacioni në vijim:

- 1) aktvendim për regjistrim në regjistrin tregtar të lëshuar nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
- 2) vendimi për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për kabare, klub të natës, disko-klub dhe disko-klube në hapësira të hapura, të miratuara nga këshilli i komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit, këshilli i komunës së qytetit të Shkupit;
- 3) fletëparaqitje për plotësimin e kushteve minimale-teknike për kryerjen veprimtarisë hoteliere;
- 4) me pëlqim prej organit të administratës shtetërore për punët nga sfera e punëve të brendshme për shkak se kushtet e plotësuara për mbrojtje të rendit publik dhe qetësisë dhe sigurisë të komunikacionit dhe
- 5) dëshmi për taksën administrative të paguara prej 50 denarësh.

Personi zyrtar nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë, që udhëheq procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 pikat 1,2,3 dhe 4 nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.

Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Lartësinë e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton Kuvendi i komunës, kurse për Qytetin e Shkupit, Këshilli i Qytetit të Shkupi.

Kompensimi nga paragrafi 1 i këtij neni 50% paguhet në llogari të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit në llogari të Qytetit të Shkupit, ndërsa 50% paguhet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagimit.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Ministria e Ekonomisë 30 ditë para skadimit të afatit të vlefshmërisë të licencës së dhënë paraprakisht e përkujton bartësin e lejes për periudhën e vlefshmërisë së të njëjtës.

Përkujtimi kryhet përmes dorëzimit të porosisë elektronike në e-mail adresën nga gjendja rrjedhëse e personit juridik.

Përkujtimi mund të kryhet edhe me SMS-porosi, nëse bartësit e licencës kanë dhënë pëlqim paraprak se kjo do të jetë në shpenzim të tyre.

Neni 21-a

Kundër aktvendimit të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë, me të cilën është refuzuar kërkesa për lëshim të licencës mund të parashtrohet ankesë në Komisionin Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallën e dytë.

Neni 21-b

Licenca për kryerjen e veprimtarisë hoteliere në bar, kabare, disko klub, dhe disko klub në vend të hapur hiqet me vendim të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë, në

raste kur bartësi i licencës nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në pajtim me këtë ligj.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë.

Neni 22

Licenca nga neni 20 të këtij ligji lëshohet në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës nga ana e kryerësit të veprimtarisë hoteliere dhe vlen për periudhë njëvjeçare.

Licenca nuk mund të bartet.

Neni 22-a

I fshirë 4

4. KOHA E PUNËS SË OBJEKTEVE HOTELIERE

Neni 23

Hotelieri mund të organizojë kryerjen e veprimtarisë hoteliere gjatë kohës së punës, edhe atë:

1) Objektet hoteliere për vendosje (hotelet, motelet, pansionet, vendbanimet turistike, bujtinat dhe pushimoret) mund të punojnë prej orës 00,00 deri në orën 24,00, ndërsa objektet hoteliere për ushqim të cilat janë në përbërje të objekteve për vendosje, pas orës 24,00 mund të japin vetëm shërbime hoteliere për ushqim të shpejtë.

2) Objektet hotelierike për ushqim nga neni 19 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji, të cilat paraqesin një tërësi ndërtimore të vendosur në vendkalime kufitare, aeroporte, stacione hekurudhore dhe pompa të benzinës mund të punojnë nga ora 00,00 deri në ora 24,00;

3) Objektet hoteliere për ushqim pa dallim të llojit të shërbimeve hoteliere, mund të punojnë prej orës 07,00 deri në orën 24,00, ndërsa më 31 dhjetor deri në orën 07,00 ditën e ardhshme;

4) Objektet hoteliere për ushqim pa dallim të llojit të shërbimeve hoteliere në ditët e premte dhe e shtunë, para ditëve festive dhe ditëve të festave, si dhe në periudhën prej 01 korriku deri më 31 gusht dhe në periudhën prej 25 dhjetorit deri më 15 shkurt, mund të punojnë prej orës 07,00 deri më orën 01,00 ditën vijuese, ndërsa më 31 dhjetor deri në orën 07,00 ditën e ardhshme, 01 dhe 02 janar deri më orën 03,00 ditën vijuese.

5) Objektet hoteliere bar nate dhe kabaretë mund të punojnë prej orës 20,00 deri më orën 04,00 ditën vijuese, në ditët e premte dhe e shtunë, para ditëve festive dhe ditëve të festës, si dhe gjatë periudhës prej 1 korriku deri më 31 gusht dhe në periudhën prej 25 dhjetorit deri më 15 shkurt, mund të punojnë prej orës 20,00 deri më orën 05,00 ditën vijuese, ndërsa më 15 shkurt mund të punojnë prej orës 20,00 deri më orën 05,00 ditën vijuese, ndërsa më 31 dhjetor deri në orën 20 ditën e ardhshme, 01 dhe 02 janar deri më orën 06,00 ditën vijuese.

6) Objekti hoteliere disko-klub dhe disko-klub në sipërfaqe të hapur mund të punojë prej orës 19,00 deri në orën 04,00 ditën vijuese, në ditët ditët e premte dhe e shtunë, në prag të ditëve festive dhe ditëve festive, si dhe në periudhën prej 01 qershorit deri më 31 gusht dhe në periudhën prej 25 dhjetor deri më 15 shkurt, mund të punojnë prej orës 19,00 deri në orën

05,00 ditën vijuese, ndërsa më 31 dhjetor deri në orën 19 ditën e ardhshme, 01 dhe 02 janar deri në orën 06,00 ditën vijuese.

Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi 1 pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, objektet hoteliere për ushqim të shpejtë (dyqan sandviçësh) mund të punojnë deri në orën 01.00 në periudhën e dimrit, gjegjësisht deri në orën 02.00 në periudhën e verës, ndërsa në ditët e premtë dhe e shtunë, në prag të ditëve të festave dhe gjatë ditëve të festave deri në orën 05.00.

Këshilli i komunës ose të Këshilli i Qytetit të Shkupit, për manifestime të caktuara, turistike kulturore dhe të llojeve tjera, të përfshira në programet vjetore, mund ta vazhdojnë orarin e punës më së shumti për dy orë, për objektet hotelierike nga paragrafi 1 i këtij neni, por në kohëzgjatje më së shumti deri në tri ditë.

Neni 24

Hotelieri në mënyrë të pavarur e cakton kohën e punës së objektit në pajtim me nenin 23 të këtij ligji sipas interesave të tij afariste, karakteristikave të rajonit në të cilin kryhet veprimtaria hoteliere dhe nevojave të shfrytëzuesve të shërbimeve.

Neni 25

Hotelieri është i obliguar që orën e fillimit të kohës së punës dhe orarin e punës t'ia paraqesë prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefektit të komunës së rajonit të Qytetit të Shkupit, si dhe Inspektoratit shtetëror për punë në afat prej tetë ditëve para ditës së fillimit të kryerjes së veprimtarisë hoteliere dhe para ndryshimit të orës dhe orarit të kohës së punës së objektit hotelier.

Prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefekti i komunës së rajonit të Qytetit të Shkupit, mban evidencë për kohën e punës së objekteve hoteliere që punojnë në rajonin e kompetencës së tyre.

Në rast të shkaqeve objektive, të cilat kërkojnë mbylljen e objektit hotelier apo ndryshime të kohës së punës në të cilat hotelieri nuk mund të ndikojë, hotelieri mund ta mbyllë objektin hotelier, përkatësisht ta ndryshojë orarin e punës pa e plotësuar obligimin nga paragrafi 1 i këtij neni. Për këtë është i obliguar ta informojë prefektin e komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefektin e komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Inspektoratin shtetëror për punë në afat prej pesë ditëve nga dita e paraqitjes së shkakut.

Hotelieri e paraqet fletëparaqitjen e formularit për caktimin e orës së fillimit të orarit të punës dhe orarin e punës.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i punës dhe politikës sociale, përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit për caktimin e orës së fillimit të kohës së punës dhe orarin e punës.

Neni 26

Hotelieri është i obliguar që orarin e punës ta vendosë në hyrje të objektit dhe në vend të dukshëm në objekt.

Hotelieri është i obliguar t'i përmbahet orarit të punës nga nenet 23 dhe 25 të këtij ligji.

5. KATEGORIZIMI I OBJEKTEVE HOTELIERE

Neni 27

Objektet hoteliere për vendosje (hoteli, moteli, pansioni, apartamenti turistik dhe kampi shtëpi alpinistësh dhe të gjuetisë dhe), si dhe objekti hotelier për ushqim restorant, dhe restorant nacional - mejhane para fillimit me kryerjen e veprimtarisë detyrimisht kategorizohen sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara për lloje të caktuara të këtyre objekteve sa i përket rregullimit, pajisjes dhe kualitetit të shërbimeve me yje. ⁵

Shtëpitë, banesat dhe dhomat për dhënie nga ana e personave fizikë dhe amvisërive të fshatit, detyrimisht kategorizohen sipas kushteve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 27-a

Kategorizimin e objekteve hoteliere për vendosje nga neni 27 paragrafi 1 e kryen Komisioni për Kategorizimin e Objekteve Hoteliere (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), i formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Komisioni punon në përbërje prej 13 anëtarëve, prej të cilëve tre përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, tre përfaqësues të Zyrës së kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, një përfaqësues i Kabinetit të zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i ngarkuar për çështje ekonomike dhe për koordinim me resorët ekonomikë, një përfaqësues i Ministrisë së Financave, një përfaqësues i Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, një përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, një përfaqësues i Agjencisë së Promovimit dhe Mbështetjes së Turizmit dhe një përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror të Tregut.

Anëtarët e Komisionit kanë zëvendësit e tyre.

Anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Komisionit duhet të jenë me arsim të lartë të mbaruar nga sfera e ndërtimtarisë, arkitekturës, ekonomisë, turizmit dhe hotelerisë dhe së drejtës, në varësi nga kompetencat e organeve të administratës shtetërore prej ku propozohen.

Kryetari i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Komisionit, për periudhë prej një viti, sipas parimit të ndërrimit.

Për punën e Komisionit, anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve u takon kompensimi.

Mënyra e punës së Komisionit nga afër rregullohet me Rregulloren e Punës, të cilën e miraton Komisioni me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Punët profesionale dhe punët teknike administrative për nevojat e Komisionit i kryen njësia organizative kompetente për punët nga sfera e turizmit dhe hotelerisë në Ministrinë e Ekonomisë.

Neni 27-b

Komisioni nga neni 27-a ka autorizim të kryejë kategorizimin e objekteve hoteliere për vendosje të theksuar në nenin 27 paragrafin 1 të këtij ligji.

Për kategorizimin e kryer, Komisioni përgatit raport me propozim për kategorinë e caktuar të objektit hotelierik, në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për kategorizim.

Raporti nga paragrafi 2 i këtij neni përgatitet në bazë të këqyrjes së kryer drejtpërdrejtë nga Komisioni në objektin hotelierik që është lëndë e kërkesës për kategorizim. Pjesë përbërëse e Raportit nga paragrafi 2 i këtij neni është materiali i dokumentuar me fotografi që shfrytëzohet si dëshmi për përmbushjen e kushteve dhe standardeve sipas të cilave bëhet kategorizimi, si dhe kategoria e propozuar për objektin hotelierik dhe mënyra e votimit të secilit anëtar të Komisionit, veçmas, me arsyetim përkatës për kategorinë e propozuar.

Raporti nga paragrafi 2 i këtij neni, miratohet dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe ky dërgohet te Ministria e Ekonomisë në afat prej 3 ditësh nga dita e miratimit të tij.

Në bazë të Raportit nga paragrafi 2 i këtij neni, Ministria e Ekonomisë më së voni në afat prej 15 ditësh nga pranimi i Raportit e dërgon këtë te Qeveria e Republikës së Maqedonisë me Propozim-aktvendim për përcaktimin e kategorisë së objektit hotelierik.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, miraton aktvendim për përcaktimin e kategorisë së objektit hotelierik, me periudhë të vefshmërisë prej tri vitesh.

Nëse objektit hotelierik i është përcaktuar kategoria, më e lartë se ajo e propozuara në kërkesën nga neni 27-v paragrafi 2 pika 4, në aktvendimin nga paragrafi 6 i këtij neni, parashihet obligimi për aplikantin në kategorizimin për të kryer pagesë shtesë të kompensimit deri në shumën për kategorinë përkatëse nga neni 27-g paragrafi 1 të këtij ligji.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 6 i këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Aktvendimi nga paragrafi 6 i këtij neni, bashkë me Raportin nga paragrafi 2 i këtij neni, publikohen në ueb faqen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Ministria e Ekonomisë e dorëzon aktvendimin nga paragrafi 6 i këtij neni, te aplikanti i kategorizimit, në afat prej pesë ditësh, nga dita e miratimit të tij.

Ministri i cilli udhëheq me organin e administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë i përcakton formën dhe përmbajtjen e Raportit nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 27-v

Kërkesa për kategorizim të objektit hotelierik për akomodim nga neni 27 paragrafi 1, i dorëzohet Komisionit për kategorizim të përcaktuar në nenin 27-a të këtij ligji, përmes njësisë organizative kompetente për punët nga sfera e turizmit dhe hotelerisë.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni, i përmban të dhënat në vijim:

- 1) firmën dhe adresën e hotelerisë;
- 2) llojin, emërtimin dhe selinë e objektit hotelierik;
- 3) shërbimet të cilat do të jenë lëndë e punës së objektit hotelierik;
- 4) propozim-kategorinë e objektit hotelierik;

Me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni paraqitet edhe dokumentacioni në vijim:

- 1) aktvendim për regjistrim në regjistrin tregtar, ose dokumentin për veprimtarinë e regjistruar;
- 2) fletëparaqitje Inspektorati Shtetëror i Tegut për përmbushjen e kushteve teknike minimale për punë;
- 3) të dhëna dhe dhëmi për udhëheqësit dhe të punësuarit tjerë dhe
- 4) dëshmi fletëpagesë për kompensim pagesor në Ministrinë e Ekonomisë për shërbimin - kategorizim.

Personi zyrtar nga organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e hotelerisë, që e udhëheq procedurën, me detyrë zyrtare i merr dëshmitë nga paragrafi 3 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nga organet publike kompetente, në afat prej tri ditë pune nga parashtrimi i kërkesës.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent është i detyruar që dëshmitë nga paragrafi 4 i këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri i cilli udhëheq me organin e administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 27-g

Kompensimi nga neni 27-v, paragrafi 3 pika 4 është në shumë prej:

- 100 euro, në kundërvlerë me denarë për kategorinë e objektit hotelierik me një yll.
- 200 euro, në kundërvlerë me denarë për kategorinë e objektit hotelierik me dy yje.
- 300 euro, në kundërvlerë me denarë për kategorinë e objektit hotelierik me tre yje.
- 400 euro, në kundërvlerë me denarë për kategorinë e objektit hotelierik me katër yje.
- 500 euro, në kundërvlerë me denarë për kategorinë e objektit hotelierik me pesë yje.

Nese objektit hotelierik i është përcaktuar kategoria, më e lartë se ajo e propozuara në kërkesën nga neni 27-v paragrafi 2 pika 4, aplikanti i kategorizimit ka për obligim që në afat prej pesë ditësh nga pranimi i aktvendimit nga neni 27-b paragrafi 6 të kryejë pagesë shtesë të kompensimit deri në shumën për kategorinë përkatëse nga paragrafi 1 i këtij neni.

Nese objektit hotelierik i është përcaktuar kategoria, më e ulët se ajo e propozuara në kërkesën nga neni 27-v paragrafi 2 pika 4, Ministria e Ekonomisë ka për obligim që aplikantit të kategorizimit t'ia kthejë dallimin ndërmjet kompensimit i cili e ka paguar për kategorinë e propozuar dhe shumën e paraparë për kategorinë e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Nese, aplikanti i kategorizimit nuk vepron në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, aktvendimin nga neni 27-b paragrafi 6 është i pavlefshëm dhe objekti hotelierik nuk mund të fillojë me punë.

Nese, Ministri i Ekonomisë nuk vepron në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, aplikanti i kategorizimit ka të drejtë të ngrejë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Neni 27-d

Shpenzimet për kategorizim të objektit hotelierik për akomodim nga neni 27 paragrafi 1 dhe kompensim të anëtarëve të Komisionit nga neni 27-a i bart hotelieri.

Shpenzimet nga paragrafi 1 i këtij neni dhe kompensimet e anëtarëve të Komisionit nga neni 27-a dhe të Komisionit nga neni 27-gj i cakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 27-gj

Mbikëqyrjen të punës së Komisionit nga neni 27-a dhe mbikëqyrje të mbajtjes së kriterëve në bazë të të cilave është marrë kategoria përkatëse, nga ana e hotelierit, e kryen Komisioni për mbikëqyrje të formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni Mbikëqyrës).

Komisioni për Mbikëqyrje të Punëve në përbërje prej pesë anëtarësh nga të cilat: një me propozim të Ministrisë së Ekonomisë, një me propozim të Zyrës së kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, një me propozim të Kabinetit të zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i ngarkuar për çështje ekonomike dhe për koordinim me resorët ekonomikë, një me propozim të Ministrisë së Financave dhe një përfaqësues me propozim të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje kanë zëvendës të tyre.

Anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje nevojitet të kenë të kryer arsim të lartë nga sfera e ndërtimtarisë, arkitekturës, ekonomisë, turizmit dhe hotelierisë dhe të drejtës.

Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Komisionit, për periudhë prej një viti, sipas principit të rrotullimit.

Për punën në Komisionin për Mbikëqyrje, anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve i takon kompensim.

Mënyra e punës së Komisionit për Mbikëqyrje me afërsisht rregullohet me Rregullore për punë, të cilin e miraton Komisioni me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Punët profesionale dhe administrative për punët e Komisionit për Mbikëqyrje i kryen Sektori për turizëm dhe hotelieri në Ministrinë e Ekonomisë.

Neni 27-e

Komisioni për Mbikëqyrje është i detyruar të kryejë së paku pesë mbikëqyrje të rregullta në nivel mujor, në objekte hotelierike nga kategori të ndryshme.

Komisioni për Mbikëqyrje është i detyruar që të kryejë mbikëqyrje të jashtëzakonshme për parashtesa të personave fizikë dhe juridikë për mospërmbushjen e kriterëve për kategorizim në objektet hotelierike për akomodim nga neni 27, paragrafi 1 i këtij ligji.

Për mbikëqyrjen e kryer, Komisionit për Mbikëqyrje përpilon procesverbal, pjesa përbërëse e të cilit është edhe shtojca me material të dokumentuar fotografik.

Në bazë të procesverbaleve nga mbikëqyrja e kryer në muajin paraprak, më së voni deri me datën 5 në muajin e ardhshëm, Komisioni për

Mbikëqyrje dorëzon Raport për mbikëqyrjen e kryer, me propozim-masa në Ministrinë e Ekonomisë.

Raporti nga paragrafi 4 i këtij neni, miratohet dhe nënshkruhet nga ana e të gjitha anëtarëve të Komisionit

Në bazë të Raportit nga paragrafi 4 i këtij neni, Ministria e Ekonomisë më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Raportit i dorëzon të njëjtin në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, me propozim-masa për tejkalimin e mangësi të cilat mund të jenë për zvogëlimin përkatësisht zmadhimin e kategorisë, me propozim-masa kundër anëtarëve, përkatësisht zëvendësanëtarëve të Komisionit nga neni 27-a të këtij ligji.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton aktvendim të ri për përcaktimin e kategorisë së objektit hotelierik. Me propozim të Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa në bazë të Raportit të Komisionit nga neni 27-gj, me periudhë të vlefshmërisë prej tre vjet.

Kundër aktvendimit të paragrafit 7 të këtij neni, mund të ngritet procedurë administrative në gjykatën kompetente, në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit.

Aktvendimi i paragrafit 7 të këtij ligji, bashkë me raportin e paragrafit 4 të këtij neni publikohen në ueb faqen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Ministria e Ekonomisë e dërgon aktvendimin nga paragrafi 7 i këtij neni, të kërkuar i kategorizimit, në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të tij.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e hotelierisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit nga paragrafi 4 i këtij neni.

Neni 28

Kategorizimi i objekteve hotelierike për ushqim nga neni 27 paragrafi 1 e kryejnë komisione për kategorizimin e objekteve hotelierike (në tekstin e mëtejshëm: Komisione) të përbëra prej pesë anëtarëve, të cilët kanë zëvendës.

Komisionet nga paragrafi 1 i këtij neni i formon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në fushën e hotelierisë prej një përfaqësuesi nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët në fushën e hotelierisë, përfaqësues i organit të administratës shtetërore kompetent nga fusha e shëndetësisë, përfaqësues i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e Punës dhe politikës sociale, përfaqësues nga vetadministrimi lokal në rajonin e të cilit bëhet kategorizimi dhe përfaqësues i ekonomisë hoteliere.

Njëri nga anëtarët e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelierisë në Komisionet nga paragrafi 1 i këtij neni, është edhe kryetar i Komisionit.

Për kategorizimin e bërë Komisionet marrin vendime në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës, me periudhë të vlefshmërisë prej tre viteve.

Kundër vendimeve nga paragrafi 4 i këtij neni mund t'i ushtrohet ankesë Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 29

Vendimi nga neni 28 paragrafi 4 i këtij ligji jepet me kërkesën e hotelierit dërguar Komisionit për kategorizim.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni parashtrohet në formular i cili përmban:

- 1) të dhëna nga regjistrimi në regjistrin tregtar;
- 2) firmën dhe adresën;
- 3) llojin, emrin dhe selinë e objektit të hotelierisë;
- 4) shërbimet që do të jenë lëndë e punës së objektit hotelierik;
- 5) lajmërimin - fletëparaqitjen për punë;
- 6) propozimin e kategorizimit të objektit hotelierik, dhe
- 7) të dhëna dhe dëshmi për udhëheqësit dhe të punësuarit tjerë.

Personi fizik nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelierisë, që e mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 pikat 1), 2), 5) dhe 7) të këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.

Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelierisë.

Neni 29-a

I fshirë 6

Neni 30

Shpenzimet për kategorizimin e objektit për ushqim nga neni 27 paragrafi 1 i mban hotelieri.

Shpenzimet nga paragrafi 1 të këtij neni i përcakton ministri, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelierisë.

Neni 31

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelierisë mban regjistër për objektet e kategorizuara hoteliere.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelierisë, përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën mbajtjes së regjistrit të objekteve të kategorizuara hoteliere.

Neni 32

Objekti hotelierik nga neni 27 i këtij ligji nuk mund të fillojë me punë para se ta marrë aktvendimin e nenit 27-b paragrafi 6, ose aktvendimin nga neni 28 paragrafi 4 i këtij ligji, në të cilin është përcaktuar kategoria e objektit hotelierik, nga ana e Komisionit kompetent për kategorizim.

Në hyrjen e çdo objekti hotelier nga neni 27 i këtij ligji, në vend të dukshëm doemos duhet të vendoset shenja e llojit dhe kategorizimit të objektit hotelier, me ç'rast gjatë shpalljes dhe reklamimit të shërbimeve të

veta, hotelieri doemos duhet ta përdorë vetëm këtë shenjë të llojit dhe kategorizimit të objektit.

Neni 33

Vendimi për përcaktimin e kategorizimit të objektit hotelierik rruhet në çdo objekt për të cilin është caktuar kategorizimi.

Nëse bëhen ndryshime në standardet e përcaktuara për kategorinë e objektit hotelier të caktuar për rregullimin, pajisjen dhe kualitetin e shërbimeve, hotelieri është i obliguar të paraqesë kërkesë për kategorizim të ri në afat prej tetë ditëve nga dita e ndryshimit të standardeve të përcaktuara (kushteve) për kategorizimin e objektit hotelier.

Nëse hotelieri nuk vepron sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, vendimi për kategorizim llogaritet si i pavlerë.

Ndryshimi i kategorisë së objektit hotelier bëhet në mënyrë dhe me procedurë të përcaktuar për caktimin e kategorisë së objektit hotelier.

Komisioni kompetent në bazë të kërkesës ose kallëzimit, mund të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse objekti hotelierik i plotëson standardet për të cilat me aktvendim i është caktuar kategori e caktuar, para skadimit të afatit të aktvendimit për përcaktimin e kategorisë së objektit hotelierik. Nëse Komisioni Kompetent përcakton se objekti hotelierik u shmanget standardeve në bazë të cilave i është përcaktuar kategoria, do të lëshojë aktvendim të ri për kategorizim në kategori adekuate për të cilën i plotëson standardet. ⁷

IV. OBLIGIMET E HOTELIERIT GJATË KRYERJES SË VEPRIMTARISË

Neni 34

Hotelieri për çdo objekt hotelier doemos duhet të caktojë person përgjegjës (drejtor, udhëheqës, shef dhe ngjashëm) në objektin hotelier.

Personi përgjegjës, përsëri plotësimi të kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës, të përcaktuara me ligj, doemos duhet të ketë së paku edhe përgatitje të mesme profesionale.

Personi përgjegjës në objektin hotelier për vendosje, i cili është kategorizuar me katër, pesë yje dhe kategori de luks, si dhe personi përgjegjës në objektin hotelier për ushqim të kategorizuar me katër yje, duhet të ketë arsimim sipëror.

Me përjashtim nga dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni, hotelieri mund të ketë një person përgjegjës edhe për më shumë objekte hoteliere për vendosje (më shumë lloje të objekteve hoteliere).

Nëse hotelieri personalisht udhëheq punën e objektit hotelier doemos duhet t'i plotësojë kushtet e përshkruara për personin përgjegjës.

Personi përgjegjës është kompetent për punën e objektit në pajtim me këtë ligj.

Neni 35

Hotelieri është i obliguar:

- 1) t'i mirëmbajë hapësirat dhe pajisjen dhe të japë shërbime në objektin hotelier sipas kushteve të përcaktuara minimale teknike, si dhe kushteve për kategorizim për llojet e objekteve për të cilat është paraparë kategorizimi i përcaktuar me aktvendim të Komisionit për kategorizim, ose sipas kritereve të përcaktuara për shënim të llojeve të posaçme të objekteve hoteliere për të cilat është paraparë dhënia e shenjave të posaçme me aktvendim të dhënësit të shenjës;
- 2) t'i vë çmimet për vendosjes, pansion dhe gjysmëpansion në dhomat dhe të mundësojë shikim në çmimet e këtyre shërbimeve të shfrytëzuesve të shërbimeve, në recepsion, si dhe t'i vendosë çmimet e ushqimit, pijeve dhe lëngjeve në listat e zakonshme të çmimeve dhe në ekzemplarë të mjaftueshëm, të arritshëm për shfrytëzuesit e shërbimeve në çdo kohë;
- 3) në vend të dukshëm në hyrjen e objektit hotelier - bar natë dhe kabare në tabelë me dimensione 20 x 50 cm të vë mbishkrim me përmbajtje: "persona me moshë nën 18 vjet nuk kanë të drejtë për vizitë". Hotelierët janë të obliguar ta vërtetojnë moshën e personave para hyrjes së tyre në objekt.
- 4) të përmbahet në çmimet e theksuara;
- 5) të posedojnë dokumente për prodhimet furnizuara (fatura, llogari, fletëdalje dhe të ngjashme);
- 6) për çdo shërbim të dhënë të jepet llogari me specifikat e shërbimeve nga arka fiskale;
- 7) në vend të dukshëm në hyrje të objektit hotelier ta theksojë llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytëzohen;
- 9) t'i dorëzojë normat për ushqim në verifikim te prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit te prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit dhe shërbimet hoteliere t'i ofrojë në masë përkatëse dhe kualitet sipas normave të përcaktuara nga pika 5 paragrafi 1 i këtij neni;
- 10) të mbajë libër të mysafirëve në objektin hotelier për vendosje;
- 11) ta përcaktojë dhe vendosë rendin shtëpiak në të gjitha objektet për vendosje;
- 12) në objektet hoteliere për vendosje të japë shërbime hoteliere të përfshira në pakon aranzhmanet turistike përmes organizatorëve të udhëtimit apo ndërmjetësve, përkatësisht agjencive turistike;
- 13) në vend të dukshëm në objektin hotelier ta paraqesë obligimin për angazhim të udhërrëfyesit turistik vendor gjatë qëndrimit të organizuar të turistëve të huaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për veprimtari turistike;
- 14) në vend të dukshëm në objektin hotelier apo në mënyrë ta vë numrin e telefonit të Inspektoratit shtetëror të tregut;
- 15) në të gjitha materialet propaganduese t'i shënojë llojin dhe kategorinë e objektit që është përcaktuar me vendimin e Komisionit për kategorizim.

Mënyrën e përcaktimit të moshës nga paragrafi 1 pika 3, e përcakton ministri i cili udhëheq organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 36

Në objektet hoteliere është e ndaluar shitja dhe oferta për shitje, si dhe marrja e substancave apo preparateve që janë shpallur si drogë dehëse apo substanca psikotropike.

Neni 37

Në objektet hoteliere është e ndaluar shërbimi i pijeve alkoolike personave nën 18 vjet dhe shërbimi i pijeve alkoolike personave të mitur.

Hotelierët janë të obliguar që në vend të dukshëm në objektin hotelier të vendosin mbishkrim me përmbajtje "persona me moshë nën 18 vjet nuk shërbehen me pije alkoolike", në tabelë me dimensione 20 x 50 cm.

Hotelierët janë të obliguar ta vërtetojnë moshën e personit nga paragrafi 1 i këtij neni në bazë të dokumentit përkatës.

Neni 38

Në objektet hoteliere është i ndaluar shërbimi i pijeve alkoolike nga fillimi i kohës së punës prej orës 07,00 deri në orën 10,00.

Në objektet hoteliere për ushqim të shpejtë (dyqan sandviçësh) është e ndaluar shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike, si dhe të lëshojnë muzikë pas orës 24.00.

Neni 39

Kryerësit e veprimtarisë hoteliere mund të kryejnë edhe veprimtari të tjera, me të cilat plotësohet kryerja e veprimtarisë hoteliere dhe kontribuohet për shfrytëzim më të mirë të kapaciteteve hoteliere dhe realizimin e qarkullimit më të madh nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ana e organeve të administratës kompetentë për kryerjen e këtyre veprimtarive.

V. DHËNIA E SHËRBIMEVE TË TJERA HOTELIERE DHE SHËRBIMEVE HOTELIERE NGA PERSONA FIZIKË

Neni 40

Personat fizikë nga neni 4 paragrafi 2 të këtij ligji mund të japin:

- shërbime të konfeksionuara hoteliere në objekte lëvizëse të destinura;
- shërbime hoteliere për vendosje dhe ushqim në shtëpi;
- shërbime hoteliere në apartamente dhe dhoma për pushim;
- shërbime hoteliere në amvisëri fshatare; dhe
- shërbime hoteliere në objektet lundruese.

1. DHËNIA E SHËRBIMEVE TË KONFEKSIONUARA NË OBJEKTE LËVIZËSE TË DESTINUARA

Neni 41

Shërbimet hoteliere të konfeksionuara mund të jepen në objektet lëvizëse (në tekstin e mëtejme: objekte) me tërheqje vetanake ose ngrehëse, nëse i plotësojnë kushtet minimale-teknike dhe kushte të tjera të përcaktuara me ligj.

Dhënia e shërbimeve hoteliere nga paragrafi 1 i këtij neni mund të bëhet në vende të caktuara nga prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit nga prefekti i Qytetit të Shkupit në: panaire, panaire lokale dhe manifestime të tjera.

Në objektin nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shiten dhe/ose në sportele të shërbehen ushqime në gjendje të konfeksionuar (paraprakisht të

përgatitura në lokalin afarist dhe të paketuara), pije joalkoolike, lëngje dhe akullore e prodhuar dhe e pakëtuar nga fabrika në pajtim me kushtet sanitare-shëndetësore.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë i përcakton kushtet minimale-teknike të objekteve për kryerjen e veprimtarive hoteliere nga paragrafi 1 i këtij neni dhe mënyrën e dhënies së të njëjtave.

2. Kampimi

Neni 42

I fshirë 8

Neni 43

I fshirë

Neni 44

I fshirë

Neni 45

I fshirë

3. DHËNIA E SHËRBIMEVE HOTELIERE NË SHTËPI, APARTAMENTE DHE DHOMA PËR PUSHIM

Neni 46

Me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe dispozita tjera, në një objekt nën kulm të përbashkët mund t'u lëshohen leje për kryerjen e veprimtarisë hoteliere më shumë personave fizikë, me ç'rast një person i njëjtë fizik mund të:

1) Marrë me qira banesa për pushim dhe dhoma në ndërtesa kolektive banesore, pronari i të cilave është bartës i së drejtës së shfrytëzimit, me ç'rast personi mund të marrë më shumë se një leje për kryerjen e veprimtarisë hoteliere, por me këtë rast numri i përgjithshëm i banesave për pushim dhe dhoma në të cilët kryen veprimtari hoteliere në bazë të të gjitha aktvendimeve të lëshuara një personi të njëjtë të mos i tejkalojë 10 dhoma ose 20 shtretër.

2) Marrë me qira shtëpi, apartamente dhe dhoma për pushim në objekte individuale banesore pronar i të cilës është bartës i të drejtës së shfrytëzimit, me ç'rast në një objekt individual banesor nën kulm të përbashkët mund të lëshohen më shumë se një leje, por me këtë rast numri i përgjithshëm i apartamenteve dhe dhomave për pushim në të gjithë objektin në bazë të të gjithë aktvendimeve të lëshuara për kryerjen e veprimtarisë hoteliere të mos i tejkalojë 10 dhoma ose 20 shtretër.

Neni 47

Për dhënien e shërbimeve hoteliere prej personave fizikë në objektet nga neni 46 i këtij ligji, doemos duhet t'i plotësojnë kushtet minimale-teknike dhe kushtet për kategorizim në kuptim të nenit 27 paragrafi 1 i këtij ligji.

Kategorizimin e objekteve nga neni 27 paragrafi 2 të këtij ligji e bën prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, prefekti i Qytetit të Shkupit.

Neni 47-a 9

Kryetari i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, kryetari i Qytetit të Shkupit, mban regjistër për objektet e kategorizuara të hotelerisë nga neni 27 paragrafi 2 i këtij ligji.

Kryetari i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, kryetari i Qytetit të Shkupit, deri më 15 janar në vitin rrjedhës, për vitin paraprak dorëzon ekstrakt nga regjistri nga paragrafi 1 i këtij neni, te organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet në fushën e hotelerisë, me qëllim të formimit të bazës së të dhënave në nivel shtetëror.

Kryetari i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit kryetari i Qytetit të Shkupit, dy herë në vit, deri më 15 janar të vitit rrjedhës për vitin paraprak dhe deri më 15 qershor në vitin rrjedhës, dorëzon raport për ndryshimet e bëra në regjistrin nga paragrafi 1 i këtij neni, te organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet në fushën e hotelerisë.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi 1 i këtij neni si edhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dorëzimit të ekstraktit nga regjistri nga paragrafi 2 i këtij neni dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dorëzimit të raportit nga paragrafi 3 i këtij neni, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet në fushën e hotelerisë.

Neni 48

Personi fizik i jep dhomat, apartamentet, shtëpitë dhe banesat për pushim përmes agjencisë turistike dhe byrosë turistike në bazë të marrëveshjes.

Neni 49

Marrëveshja nga neni 48 i këtij ligji përmban:

- 1) emrin dhe mbiemrin e personit fizik dhe NUA;
- 2) vendimin për regjistrim në regjistër;
- 3) vendin, rrugën dhe numrin e objektit në të cilin jepen shërbimet;
- 4) llojin e shërbimeve dhe numrin e mysafirëve të cilëve mund t'u jepen shërbimet;
- 5) kategorinë e objekteve në të cilin jepen shërbimet;
- 6) shumën e provizionit ndërmjetësues;
- 7) obligimin të cilin personi fizik duhet t'i përmbahet dispozitave nga neni 47 dhe 51 të këtij ligji.

Neni 50

Marrëveshja nga neni 49 i këtij ligji pushon të vlejë me prishjen e saj.

Agjencia turistike dhe byroja turistike e cila është themeluar nga personat juridik, prishjen e marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij neni do t'ia dorëzojë njësisë rajonale të Drejtorisë për të hyra publike, policisë financiare, inspeksionit sanitar, inspektoratit shtetëror të tregut, varësisht nga selia e objektit.

Byroja turistike e cila është themeluar nga prefekti i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit prefekti i Qytetit të Shkupit, prishjen e marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij neni do t'ia dorëzojë njësisë rajonale të Drejtorisë

për të hyra publike, policisë financiare, inspektionit sanitar, prefektit të komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, prefektit të Qytetit të Shkupit dhe inspektoratit shtetëror të tregut, varësisht nga selia e objektit.

Neni 51

Personat fizikë të cilët japin shërbime në bazë të nenit 46 të këtij ligji, janë të obliguar:

- 1) në vend të dukshëm t'i vendosin llojin e përcaktuar dhe kategorinë e objektit të përcaktuar vendim nga organi kompetent;
- 2) në vend të dukshëm të hyrjes së objektit ta vendosin emrin e shërbimeve, të cilat i jep me shenjat e përcaktuara;
- 3) në lokalin në të cilin kryhen shërbimet në vend të dukshëm t'i vënë çmimet e shërbimeve për vendosje, në mënyrë të përcaktuar dhe të zakonshme, dhe t'u përmbahen çmimeve të vendosura;
- 4) t'i japin mysafirit llogari me llojin e përcaktuar, sasinë dhe çmimin e shërbimeve të dhëna (për çdo shërbim të dhënë veç e veç), kurse me rastin e dhënies së shërbimeve për vendosje, të shënohet në llogari edhe shuma e çmimit për qëndrim;
- 5) të mbajnë libër për evidentimin e mysafirëve;
- 6) në vend të dukshëm në objekt ta spikatë numrin e telefonit të Inspektoratit shtetëror të tregut.

Ministri i cili e udhëheq organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga lëmi i hotelerisë, përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të librit për evidentimin e mysafirëve.

Neni 52

Gjatë dhënies së shërbimeve në bazë të nenit 46 të këtij ligji, personave fizikë mund t'u ndihmojnë anëtarë të ekonomisë së tyre familjare.

Personat fizikë dhe anëtarët e ekonomisë së tyre familjare doemos duhet t'i plotësojnë kushtet shëndetësore për punë në hotelieri.

4. SHËRBIMET HOTELIERE NË EKONOMITË FAMILJARE FSHATARE

Neni 53

Në ekonomitë familjare fshatare jepen shërbime të dhënies së dhomave dhe apartamenteve, pronari i të cilave ose bartës i së drejtës për shfrytëzim, është anëtar i ekonomisë familjare fshatare, edhe atë më së shumti deri në 10 dhoma, përkatësisht 20 shtretër.

Shërbimet nga paragrafi 1 të këtij neni mund të jepen nëse janë plotësuar kushtet nga neni 6 i këtij ligji.

Përveç shërbimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, në ekonomitë familjare fshatare mund të përgatiten dhe të shërbehen gjellëra të ngrohta dhe të ftohta, pije dhe lëngje kryesisht nga prodhimi personal, më së shumti për 50 persona (ekskursionistë) njëkohësisht.

Në ekonomitë familjare fshatare mund të jepen shërbime për degustim të verës ose rakisë, si dhe shërbim i ushqimit nga prodhimi shtëpiak në pjesë të rregulluar të objektit banesor apo afarist, më së shumti për 50 persona (ekskursionistë) njëkohësisht.

Për shkak të përmirësimit të kualitetit të ofertës hoteliere, në ekonomitë familjare fshatare, ekskursionistët (personat të cilët qëndrojnë në ekonomitë familjare fshatare) mund të përgatisin ushqim, pije dhe lëngje për nevojat e tyre.

Për dhënien e shërbimeve në ekonomitë familjare fshatare zbatohen dispozitat nga neni 46 deri më 52 të këtij ligji.

Neni 53-a

Për shërbimet e personave fizikë në objektet hoteliere për vendosje në kuadër të amvisërive të fshatit në mjedise rurale, sipas kategorizimit të detyrueshëm jepet shenjë e posaçme.

Shenjën nga paragrafi 1 i këtij neni e jep organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të shenjës, nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 53-b

Që të mund të merret shenja nga neni 53-a paragrafi 1 i këtij ligji, objektet hoteliere për vendosje në kuadër të amvisërive të fshatit në mjedise rurale, duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- 1) kategorizim të realizuar në pajtim me nenin 47 të këtij ligji, me afat të pakaluar të vlefshmërisë;
- 2) gjatë rregullimit të jashtëm dhe të brendshëm të objektit hotelier, të përdoren materiale natyrore, si dhe motive nga kultura tradicionale, instrumente popullore, veshje, orendi-enë dhe të ngjashme dhe
- 3) ushqimet e nxehta dhe të ftohta, pijet që shërbehen të jenë nga vendi dhe të prodhuara në mënyrë ekologjike.

Mënyrën dhe kriteret më të përafërta për marrje të shenjës nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 53-v

Procedurën për marrje të shenjës nga neni 53-a të këtij ligji e zbaton Komisioni për zbatim të procedurës për marrje të shenjës për mjedise rurale (në tekst të mëtejme: Komisioni) i përbërë nga tre anëtarë, të cilët kanë zëvendës.

Komisionin e formon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë dhe është i përbërë nga një anëtar i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë, një anëtar nga dhomat turistike dhe një anëtar nga ekonomia hotelierike.

Anëtari nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë në Komision është edhe kryetar i Komisionit.

Për procedurën e zbatuar Komisioni përpilon aktvendim në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse janë plotësuar kriteret të përcaktuara në pajtim me nenin 53-a të këtij ligji.

Aktvendimi nga paragrafi 4 të këtij neni lëshohet me vlefshmëri prej tre vitesh.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 4 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Shpenzimet për marrje të shenjës nga neni 53-a paragrafi 1 i këtij ligji i bart bartësi i amvisërisë së fshatit.

Lartësia e shpenzimeve nga paragrafi 7 të këtij neni i përcakton ministri i cili menaxhon me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e hotelerisë, në bazë të shpenzimeve të bëra në mënyrë reale për punën e Komisionit dhe përgatitjen e aktvendimit.

Shpenzimet nga paragrafi 7 i këtij neni paguhen në llogarinë e të hyrave personale të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 53-g

Për marrje të shenjës nga neni 53-a paragrafi 1 të këtij ligji hotelieri parashton kërkesë të dhënësi i shenjës.

Kërkesës nga paragrafi 1 të këtij neni i bashkëngjitet:

- 1) dokument për veprimtari të regjistruar-nga regjistri i personave fizikë që kryejnë veprimtari hoteliere që udhëhiqet në komunë dhe
- 2) aktvendim për kategorizimin e kryer.

Personi fizik nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë, që mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 i këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.

Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 të këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Formën dhe përmbajtjen e ekzemplarit të kërkesës nga paragrafi 1 të këtij neni i përcakton ministri i cili e udhëheq organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë.

Neni 53-d

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë mbanë Regjistër për marrjen e shenjës për mjedise rurale.

Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga sfera e hotelerisë i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së

Regjistrin për marrjen e shenjës për mjedise rurale.

Neni 53-gj

Shenja nga neni 19-a paragrafi 1 të këtij ligji, hiqet me aktvendim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë, në rast kur bartësi i shenjës pushon t'i plotësojë kriteret e përcaktuara në pajtim me këtë ligji.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë

5. SHËRBIME HOTELIERE TË OBJEKTEVE LUNDRUESE.

Neni 54

Hotelierët dhe personat fizikë nga neni 4 të këtij ligji, nën kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe rregulla të tjera, mund të japin shërbime të ushqimit dhe shërbim të pijeve dhe lëngjeve në objekte detare.

Shërbimet nga paragrafi 1 të këtij neni mund të jepen nëse janë plotësuar kushtet nga neni 6 i këtij ligji.

Personat fizikë, shërbimet nga paragrafi 1 të këtij neni mund t'i japin më së shumti për 20 mysafirë njëkohësisht.

Shërbimet nga paragrafi 1 të këtij neni, personat fizikë nuk guxojnë t'i japin në vendngulim dhe liman, si dhe kur objekti lundruar qarkon jashtë limanit dhe vendngulimit, personave të cilët nuk gjenden në objektin lundruar për shkak të transportit.

VI. DHËNIA E SHËRBIMEVE HOTELIERE NUDISTËVE

Neni 55

Shërbimet hoteliere nudistëve mund t'u jepen në objekte hoteliere dhe kampe.

Shërbimet nga paragrafi 1 të këtij neni mund të jepen nëse janë plotësuar kushtet nga neni 6 i këtij ligji.

Në hyrje të objektit hotelier, përkatësisht kampit në të cilin u jepen shërbime hoteliere nudistëve, përskaj emrit të objektit vendoset edhe shenja se në atë objekt u jepen shërbime hoteliere nudistëve.

Hapësira rreth objekteve hoteliere dhe kampeve në të cilat u jepen shërbime hoteliere nudistëve, duhet të jetë e rrethuar.

VII. MBIKËQYRJA

Neni 56

Mbikëqyrje ndaj zbatimit të dispozitave të këtij ligji bën organi administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë.

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të dispozitave me të cilat janë përcaktuar kompetencat e organeve të tjera të administratës shtetërore, i kryejnë ato organe në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

Mbikëqyrje ndaj ligjshmërisë së punës së Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit në lidhje me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj nga lëmi i hotelerisë.

Neni 57

Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e kryejnë Inspektorati Shtetëror i Tregut dhe organet e tjera inspektuese në pajtim me autorizimet e përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër.

Neni 57-a

Në procedurën e mbikëqyrje inspektues zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për Inspektoratin Shtetëror të Tregut, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 58

Punët e mbikëqyrjes së inspeksionit të kryerësve të veprimtarisë hoteliere të regjistruara në regjistrin të cilin e mban prefekti i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit në regjistrin që e mban prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, i kryejnë inspektorët e autorizuar të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, inspektorët e autorizuar të Qytetit të Shkupit, siç janë dhënia e:

- 1) shërbimeve të konfeksionuara hoteliere në objekte destinuese të lëvizshme;
- 2) e fshirë 10
- 3) e fshirë
- 4) shërbimeve hoteliere për vendosje dhe ushqimit në shtëpi;
- 5) shërbimeve hoteliere në apartamente dhe dhoma për pushim;
- 6) shërbimeve hoteliere në ekonomi familjare fshatare; dhe
- 7) shërbimeve hoteliere në objekte lundruese.

Inspektori i autorizuar i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, mund të kryejnë edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me rregull.

Neni 59

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i tregut, përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit, konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 67-a dhe 68 të këtij ligji, inspektori shtetëror i tregut, përkatësisht inspektori i autorizuar, është i obliguar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit ku është konstatuar parregullsia, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e ekonomisë, përkatësisht kryetari i komunës dhe kryetari i qytetit të Shkupit.

Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Tregut, përkatësisht organi i administratës shtetërore i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

Edukimi mund të realizohet për më tepër parregullsi të konstatuara të njëjta apo të njëllojta për një ose më tepër subjekte.

Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

Nëse personi ose subjekti mbi të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtin e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

Nëse inspektori shtetëror i tregut ose inspektori i autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

Nëse inspektori shtetëror i tregut ose inspektori i autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para Komisionit për Kundërvajtje.

Inspektorati Shtetëror i Tregut, përkatësisht organi i administratës shtetërore i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese dhe i cili e ka organizuar dhe realizuar edukimin, mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në sferën e ekonomisë, përkatësisht kryetari i komunës dhe kryetari i qytetit të Shkupit.

Neni 60

Nëse inspektori shtetëror i tregut, përkatësisht inspektori i autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese konstaton se hotelieri:

- 1) veprimtarinë hotelierike e kryen pa regjistrim në regjistrin tregtar (neni 4 paragrafi 1);
- 2) në objektet hotelierike u shërben pije alkoolike personave më të rinj se 18 vjet dhe shërben pije alkoolike nga personat e mitur (neni 37 paragrafi 1);
- 3) veprimtaria hotelierike kryhet në objekte hotelierike bar nate, kabare dhe disko klub, pa licencë (neni 20 paragrafi 1);
- 4) kryen veprimtari hotelierike jashtë objektit afarist në hapësirë të dedikuar, rregulluar dhe pajisur për dhënien e shërbimeve hotelierike, pa leje të lëshuar nga kryetari i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit nga kryetari i Qytetit të Shkupit, për shfrytëzimin e hapësirës (neni 12 paragrafi 3);
- 5) nuk i përmbahet orarit të përcaktuar të punës (neni 26 paragrafi 2);
- 6) ofron shërbime ushqimi të mëngjesit në kundërshtim me nenin 46 paragrafi 1 pika 3 të këtij ligji;
- 7) objektet për dhënien e shërbimeve hotelierike nuk i plotësojnë kushtet minimale-teknike nga neni 47 paragrafi 1 të këtij ligji;
- 8) në vend të dukshëm nuk e vendos emrin e shërbimeve të cilat i ofron, nga neni 51 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji;
- 9) ofrimin e shërbimeve hotelierike në shtëpi, apartamente dhe dhoma për pushim, e realizon në kundërshtim me nenin 51 të këtij ligji;
- 10) në vend të dukshëm nuk e shënon llojin dhe kategorinë e objektit (neni 51 paragrafi 1 pika 1);
- 11) anëtari i amvisërisë apo personat të cilët u ndihmojnë anëtarëve të amvisërisë, nuk i plotësojnë kushtet shëndetësore për punë në hotelieri sipas nenit 52 paragrafi 2 të këtij ligji;
- 12) u ofron shërbime në objekte lundruese për më tepër se 20 mysafirë, njëkohësisht u ofron edhe shërbime në vendankorime dhe porte, si dhe kur objekti lundruar qarkullon jashtë vendankorimit dhe portit, personave të cilët nuk janë në objektin lundruar për qëllim të transportimit (neni 54 paragrafi 3);
- 13) shërbimet hotelierike në amvisëritë fshatare, i kryen në kundërshtim me nenin 53 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji;

14) objektet në të cilat ofrohen shërbime hotelierike të përgatitura, nuk i plotësojnë kushtet minimale teknike dhe kushtet tjera të përcaktuara me ligj (neni 41 paragrafi 1);

15) shërbimet hotelierike të përgatitura, kryhen në vende të cilat nuk janë të lejuara nga kryetari i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit nga kryetari i qyteti i Shkupit (neni 41 paragrafi 2) dhe

16) krahas ushqimeve në gjendje të përgatitur, shërbehen edhe ushqime tjera (neni 41 paragrafi 3);

Për veprimet nga paragrafi 1 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, do të miratojë aktvendim për ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Nëse hotelieri nuk vepron sipas sugjerimit nga neni 1 i këtij ligji, për veprimet nga paragrafi 1 pika 4 do të miratojë aktvendim për ndalim të përkohshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Për veprimin nga paragrafi 1 pika 5 të këtij neni, nëse hotelieri e tejkalon orarin e punës deri në gjysmë ore, do të miratojë aktvendim për ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej dhjetë ditësh.

Nëse tejkalimi i orarit të punës është prej gjysmë ore deri në një orë, do të miratojë aktvendim për ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

Nëse tejkalimi i orarit të punës është mbi një orë, do të miratohet aktvendim për ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Nëse hotelieri nuk vepron sipas sugjerimit nga neni 1 i këtij ligji, për veprimet nga paragrafi 1 pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15 të këtij neni, do të miratohet aktvendim për ndalim të përkohshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të tregut nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Ankesa e parashtruar kundër aktvendimit nga ky nen, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Neni 61

Për inspektor të komunës dhe të Qytetit të Shkupit mund të autorizohet person, i cili i plotëson kushtet vijuese:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) të ketë arsimim sipëror profesional nga profesioni ekonomik, juridikë ose turistik hotelierik dhe së paku dy vjet përvojë pune.

Inspektori nga paragrafi 1 i këtij neni ka legjitimacion. Përmbajtjen dhe formën e legjitimacionit të inspektorit e përcakton ministri, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelerisë.

Neni 62

Mbikëqyrja ndaj punës së Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, themelohet në parimin e ligjshmërisë, përgjegjësisë dhe pavarësisë në realizimin e kompetencave të tyre.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes ndaj punës së Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i hotelërisë, i kryen punët vijuese:

- 1) përcjell ligjshmërinë e punës së Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, dhe ndërmerr masa dhe aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave në pajtim me ligjin;
- 2) vlerëson se Këshilli dhe prefekti i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit a sigurojnë që kryerja e punës nga kompetencat e tyre të kryhen në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara me ligj;
- 3) paralajmëron Këshillin dhe prefektin e komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, Këshillin dhe prefektin e komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshillin dhe prefektin e Qytetit të Shkupit, për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe rregull tjetër dhe u propozon masa përkatëse për tejkalimin e kësaj gjendjeje;
- 4) paralajmëron për mungesa të caktuara materiale dhe procedurale në punën e Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në qytetin e Shkupit të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, të cilat do të mund ta pengonin kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, e të cilat janë me interes publik të rëndësishëm lokale;
- 5) jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, të cilat duhet t'i kryejnë në kuadrin e ligjit, e me kërkesën e tyre;
- 6) përcjell nxjerrjen me kohë të rregullave të përcaktuara me këtë ligj të Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit;
- 7) i paraqet iniciativë dhe propozime Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Shkupit, si dhe Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, nëse konstaton moszbatimin e ligjit si rezultat i ndeshjes së kompetencave ndërmjet organeve të komunës;
- 8) përcjell ligjshmërinë e vendimeve të cilat i merr prefekti në zgjidhjen e punëve administrative për të drejta, obligime dhe interesa të personave fizikë dhe juridikë të marra në bazë të këtij ligji dhe ndërmerr masa sipas autorizimit të ligjit;
- 9) me kohë i informon organet e Këshillit dhe prefektin e komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, Këshillin dhe prefektin e komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshillin dhe prefektin e qytetit të Shkupit për gjendjen e konstatuar në punën e tyre dhe për masat e marra gjatë mbikëqyrjes.

Për masat e ndërmarra dhe aktivitetet nga pika 6 dhe 8 paragrafi 2 i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelierisë, e informon Këshillin dhe prefektin e komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, Këshillin dhe prefektin e komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshillin dhe prefektin e Qytetit të Shkupit.

Nëse edhe krahas paralajmërimeve dhe masave e aktiviteteve të ndërmarra, Këshilli dhe prefekti i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, Këshilli dhe prefekti i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe Këshilli dhe prefekti i Qytetit të Shkupit nuk e sigurojnë kryerjen e punëve nga paragrafi 2 të këtij neni, me fuqinë e ligjit u merret apo u kufizohet kryerja e kompetencës përkatëse. Kryerjen e punëve të ndërmarr e merr organi kompetent i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i hotelierisë, por më së shumti deri në një vit nga dita e marrjes së tyre.

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët e hotelierisë, kryerjen e punëve të marra nga kompetenca e Këshillit dhe prefektit të komunës, kurse në Qytetin e Shkupit, të Këshillit dhe prefektit të komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit, si dhe të Këshillit dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, i kryen në emër dhe në llogari të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

Neni 63

I fshirë **11**

Neni 64

I fshirë

Neni 65

I fshirë

Neni 66

I fshirë

Neni 67

I fshirë

VIII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 67-a

12

Gjobë në shumë prej 150 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, nëse:

- 1) veprimtarinë e kryen pa qenë i regjistruar në regjistrin që e mban kryetari i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit kryetari i komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit (neni 4 paragrafi 2);
- 2) dhënien e dhomave, apartamenteve, shtëpive dhe banesave për pushim nuk e kryen përmes agjencive turistike dhe byrosë turistike në bazë të marrëveshjes (neni 48);
- 3) dhënien e shërbimeve hoteliere në shtëpi, apartamente dhe dhoma për pushim e kryen në kundërshtim me nenin 51 të këtij ligji;
- 4) shërbimet hoteliere në amvisëritë fshatare i kryen në kundërshtim me

- nenin 53 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji;
- 5) jep me qira dhoma, apartamente, shtëpi për pushim, në kundërshtim me nenin 46 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji;
- 6) siguron shërbime të mëngjesit në kundërshtim me nenin 46 paragrafi 1 pika 3 të këtij ligji;
- 7) anëtari i amvisërisë ose personat të cilët u ndihmojnë anëtarëve të amvisërisë nuk i plotësojnë kushtet shëndetësore për punë në hotelieri në kuptim të nenit 52 paragrafi 2 i këtij ligji;
- 8) shfrytëzon shenjë pa aktvendim të marrë (neni 53-v paragrafi 5);
- 9) u ofron shërbime në vendankorime dhe porte, si dhe kur objekti lundruet qarkullon jashtë vendankorimit dhe portit, personave të cilët nuk gjenden në objektin lundruet për transport (neni 54 paragrafi 4);
- 10) në vend të dukshëm nuk e vendos emrin e shërbimeve, të cilat i ofron nga neni 51 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji;
- 11) nuk mban libër për evidencë të mysafirëve (neni 51 paragrafi 1 pika 5);
- 12) ofron shërbime në objekte lundruese për më shumë se 20 mysafirë njëkohësisht (neni 54 paragrafi 3);
- 13) objektet në të cilat ofrohen shërbime hoteliere të konfeksionuara, nuk i plotësojnë kushtet minimale-teknike dhe kushtet tjera të përcaktuara me ligj (neni 41 paragrafi 1);
- 14) shërbimet hoteliere të konfeksionuara kryhen në vende që nuk janë të miratuara nga kryetari i komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit nga kryetari i Qytetit të Shkupit (neni 41 paragrafi 2);
- 15) krahas ngrënieve në gjendje të konfeksionuar shërbehen edhe ngrënie tjera (neni 41 paragrafi 3) dhe
- 16) objektet për ofrimin e shërbimeve hoteliere nuk i plotësojnë kushtet minimale teknike nga neni 47 paragrafi 1 të këtij ligji.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni personit fizik, inspektori i komunës dhe inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit do t'i lëshojë urdhërpagesë të mandatit.

Kryerësi i kundërvajtjes ka obligim në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërpagesës së mandatit ta paguajë gjobën në shumën e caktuar.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes vullnetarisht nuk e paguan gjobën nga paragrafi 1 i këtij neni, urdhërpagesa ka fuqi të dokumentit ekzekutiv dhe inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit do ta dorëzojë te organi kompetent për përmbarim të detyrueshëm për realizimin e saj.

Neni 68

Gjobë në shumë prej 800 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, nëse:

- 1) nuk ka provë se është paraqitur përmbushja e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji dhe fillimi me punë i Inspektoratit Shtetëror të Tregut, i kryetarit të komunës, kurse në qytetin e Shkupit i kryetarit të komunës në zonën e qytetit të Shkupit sipas vendit dhe selisë së objektit, përkatësisht sipas vendit ku jepen shërbime, së paku 15 ditë para fillimit të punës së objektit të hotelierisë (neni 7 paragrafi 1);
- 2) nuk ka provë se është paraqitur ndryshimi i kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji Inspektorati Shtetëror i Tregut, i kryetarit të komunës, kurse në qytetin e Shkupit i kryetarit të komunës në zonën e qytetit të Shkupit sipas vendit dhe selisë së objektit, përkatësisht sipas vendit ku jepen shërbime, në afat prej 15 ditësh nga dita e ndryshimit të bërë (neni 7 paragrafi 2);
- 3) vepron në kundërshtim me detyrat e parapara në nenin 34;

- 4) thekson, shpall dhe reklamon shërbime të objekteve të hotelerisë në kundërshtim me aktvendim për kategorizimin e kryer (neni 32 paragrafi 2);
- 5) nuk vendos në vend të dukshëm në hyrje të objektit të hotelerisë - bar i natës dhe kabare, tabelë me dimensione 20 x 50 cm me përmbajtjen "personat me moshë nën 18 vjet nuk kanë të drejtë për vizitim" (neni 35 paragrafi 1 pika 3);
- 6) nuk i thekon çmimet në pajtim me nenin 35 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji;
- 7) nuk thekson në vend të dukshëm në objektin e hotelerisë mbishkrimin me përmbajtjen "personat me moshë nën 18 vjet nuk shërbehen me pije alkoolike" (neni 37 paragrafi 2).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, inspektori shtetëror i tregut do t'i lëshojë urdhërpagesë të mandatit.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni do të lëshohet urdhërpagesë e mandatit për personin përgjegjës në personin juridik, përkatësisht për personin përgjegjës në tregtarin individ, në lartësi prej 30% të gjobës që do t'i matet personit juridik, përkatësisht tregtarit individ.

Kryerësi i kundërvajtjes ka obligim në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërpagesës së mandatit ta paguajë gjobën në shumën e caktuar nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes vullnetarisht nuk e paguan gjobën nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, urdhërpagesa e mandatit ka fuqi të dokumentit ekzekutiv dhe inspektori shtetëror i tregut do ta dorëzojë të organi kompetent për kryerje të detyrueshme për realizimin e tij.

Neni 68-a

Gjobë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, nëse:

- 1) kryen veprimtari hoteliere jashtë objektit afarist në hapësirën e dedikuar, rregulluar dhe pajisur për dhënie të shërbimeve hoteliere pa leje të lëshuar nga kryetari i komunës, kurse në qytetin e Shkupit nga kryetari i qytetit të Shkupit për shfrytëzimin e hapësirës (neni 12 paragrafi 3);
- 2) në vend të dukshëm në hyrje të objektit të hotelerisë nuk e thekson llojin e kartelave pagesore që mund të shfrytëzohen (neni 35 paragrafi 1 pika 7);
- 3) nuk ka provë për ndryshimin e bërë të kategorisë së objektit të hotelerisë në kuptim të nenit 33 paragrafi 3 të këtij ligji;
- 4) nuk e vendos orarin e punës në hyrje të objektit dhe në vend të dukshëm në objekt (neni 26 paragrafi 1);
- 5) në vend të dukshëm në objektin e hotelerisë, apo në menynë nuk e thekson numrin e telefonit të Inspektoratit Shtetëror të Tregut (neni 35 paragrafi 1 pika 12);
- 6) në të gjitha materialet propaganduese nuk e shënon llojin dhe kategorinë e objektit (neni 35 paragrafi pika 14);
- 7) nuk e përcakton dhe thekson rendin e shtëpisë në të gjitha objektet për vendosje (neni 35 paragrafi 1 pika 10). ¹³
- 8) nuk e përcakton dhe thekson rendin e shtëpisë në të gjitha objektet për vendosje (neni 35 paragrafi 1 pika 9);
- 9) në vend të dukshëm në objektin e hotelerisë, apo në menynë ta theksojë numrin e telefonit të ISHT-së (neni 35 paragrafi 1 pika 13);
- 10) në vend të dukshëm në hyrje të objektit të hotelerisë nuk e thekson

llojin e kartelave pagesore që mund të shfrytëzohen (neni 35 paragrafi 1 pika 7).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, inspektori shtetëror i tregut do t'i lëshojë urdhërpagesë të mandatit.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni do të lëshohet urdhërpagesë e kundërvajtjes për personin përgjegjës në personin juridik, përkatësisht për personin përgjegjës në tregtarin individ, në lartësi prej 30% të gjobës që do t'i matet personit juridik, përkatësisht tregtarit individ.

Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhërpagesës së kundërvajtjes, kryerësi i kundërvajtjes detyrohet ta paguajë gjobën e shqiptuar në pajtim me paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të urdhërpagesës së kundërvajtjes në llogarinë e shënuar në urdhërpagesë.

Kryerësi i kundërvajtjes që do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën të drejtë këshillohet në këshillën juridike.

Në procedurën që do të përfundojë me pagesë të urdhërpagesës së kundërvajtjes nuk paguhen shpenzimet e procedurës.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, inspektori shtetëror i tregut parashtron kërkesë për ngritje të procedurës së kundërvajtjes te Komisioni i Kundërvajtjes.

Neni 69

Gjobë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ nëse:

- 1) veprimtaria hoteliere bëhet pa u plotësuar kushtet minimale-teknike të caktuara, kushtet sanitaro-higjienike dhe shëndetësore, kushtet për mbrojtje gjatë punës, mbrojtje dhe avancimin e mjedisit jetësor, mbrojtje nga zjarri dhe kushtet për mbrojtjen nga zhurma (neni 6 paragrafët 1 dhe 2);
- 2) veprimtaria hoteliere bëhet në objekte afariste ose hapësira ku kryhet veprimtari tjetër pa u plotësuar kushtet e caktuara për shpalljen e veprimtarisë tjetër (neni 12 paragrafi 2);
- 3) përdor shenjën e restorantit-mejhanes nacionale pa fituar aktvendim në pajtim me nenin 19-v paragrafi 4 i këtij ligji;
- 4) fillon me punë në objektin hotelier pa kategorinë e fituar (neni 32 paragrafi 1);
- 5) nuk i përcakton normativat e ushqimit dhe pijeve të cilat i shërben dhe nuk u mundëson shfrytëzuesve këqyrje në ato normativa (neni 35 paragrafi 1 pika 8);
- 6) nuk i parashtron normat për ushqimin në verifikim te kryetari i komunës, kurse në Qytetin e Shkupit kryetari të komunës të rajonit të Qytetit të Shkupit dhe shërbimet hoteliere nuk i ofron sasi dhe cilësi sipas normave të përcaktuara (neni 35 paragrafi 1 pika 9);
- 7) nuk i jep shërbimet hoteliere të përfshira në pakon turistike të aranzhmaneve në objektet hoteliere për akomodim nëpërmjet organizatorëve të udhëtimit ose ndërmjetësuesve, përkatësisht agjencive turistike (neni 35 paragrafi 1 pika 12);
- 8) shërben pije alkoolike prej orës 07,00 deri në orën 10,00 (neni 38 paragrafi 1);
- 9) t'i mirëmbajë hapësirat dhe pajisjen dhe të jep shërbime në objektin

hotelier sipas kushteve minimaleteknike, si dhe për kushtet e kategorizimit për llojet e objekteve për të cilat është paraparë kategorizim i përcaktuar me aktvendim të Komisionit për kategorizim, ose sipas kritereve të caktuara për shënimin e shenjave të veçanta me aktvendim të dhënësit të shenjës (neni 35 paragrafi 1 pika 1);

10) nuk mban libër të mysafirëve në objektin hotelier për akomodim (neni 35 paragrafi 1 pika 9);

11) nuk u përmbahet çmimeve të prezantuara (neni 35 paragrafi 1 pika 4);

12) nuk posedon dokumente për prodhimet e blera (fatura, llogari-fletëdërgesa dhe ngjashëm (neni 35 paragrafi 1 pika 5) dhe

13) për çdo shërbim të dhënë nuk lëshon llogari me specifikim të shërbimeve nga kasa fiskale (neni 35 paragrafi 1 pika 6).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, personit juridik, përkatësisht tregtarit individ Inspektorati Shtetëror i Tregut do t'i lëshojë urdhërpagesë.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni lëshohet mandat-urdhërpagesë personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ, në lartësi prej 30% të gjobës që do t'i përlogaritet personit juridik, përkatësisht tregtarit individ.

Kryerësi i kundërvajtjes ka për obligim në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të mandat – urdhërpagesës të paguajë gjobën në shumë e caktuara nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes vullnetarisht nuk e paguan gjobën nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mandat-urdhërpagesa ka fuqinë e dokumentet ekzekutiv dhe inspektori shtetëror i tregut do ta dërgojë në organin kompetent për përmbarrim të detyrueshëm.

Neni 69-a

Gjobë në shumë prej 2000 euro në kundërvlerë me denarin do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ, nëse në vend të dukshëm në objektin hotelierik nuk e vendos obligimin për angazhimin e ciceronit turistik të vendit gjatë qëndrimit të organizuar të turistëve të huaj, në mënyrë të caktuar me Ligjin për veprimtari turistike (neni 35 paragrafi 1 pika 13).

Për veprimin nga paragrafi 1 i këtij neni, personit juridik, përkatësisht tregtarit individ Inspektorati Shtetëror i Tregut do t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje.

Për veprimin nga paragrafi 1 i këtij neni, lëshohet urdhërpagesë për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ, në lartësi prej 30% të gjobës që do t'i përlogaritet personit juridik, përkatësisht tregtarit individ.

Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhër pagesës për kundërvajtje, kryerësi i kundërvajtjes është i obliguar ta paguajë gjobën e shqiptuar në pajtim me paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, në afat prej tetë ditëve nga momenti i pranimit të urdhërpagesës për kundërvajtje në llogarinë e shënuar në urdhërpagesën.

Kryerësi i kundërvajtjes që do të paguajë gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, e drejtë për të cilën këshillohet në këshillën juridike.

Në procedurën që do të përfundohet me pagimin e urdhërpagesës për kundërvajtje nuk paguhen shpenzime të procedurës.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, inspektori shtetëror i tregut parashtron kërkesë për nisje të procedurës për kundërvajtje në Komisionin për kundërvajtje.

Neni 70

Gjobë në shumë prej 4000 euro në kundërvlerë me denarin, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ nëse:

- 1) veprimtari hotelierike bëhet pa regjistrim në regjistrin tregtar (neni 4 paragrafi 1);
- 2) veprimtari hoteliere bëhet në objekte hoteliere bar nate, kabare dhe disko-klub pa licencë (neni 35 paragrafi 1);
- 3) nuk i përmbahet orarit të caktuar të punës (neni 26 paragrafi 2);
- 4) e bart licencën (neni 22 paragrafi 2);
- 5) shërben alkool dhe pije alkoolike për persona nën moshën 18 vjeçare (neni 37 paragrafi 1) dhe
- 6) shet dhe shërben ushqim dhe pike alkoolike dhe lëshon muzikë pas orës 24,00 (neni 38 paragrafi 2).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, personit juridik, përkatësisht tregtarit individ Inspektorati Shtetëror i Tregut do t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, do të lëshohet urdhërpagesë për kundërvajtje për personin përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ, në lartësi prej 30% të gjobës që do t'i përlllogaritet personit juridik, përkatësisht tregtarit individ.

Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhërpagesës për kundërvajtje, kryerësi i kundërvajtjes është i obliguar ta paguajë gjobën e shqiptuar në pajtim me paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, në afat prej tetë ditëve nga momenti i pranimit të urdhërpagesës për kundërvajtje në llogarinë e shënuar në urdhërpagesën.

Kryerësi i kundërvajtjes që do të paguajë gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, e drejtë për të cilën këshillohet në këshillën juridike.

Në procedurën që do të përfundohet me pagimin e urdhërpagesës për kundërvajtje nuk paguhen shpenzime të procedurës.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, inspektori shtetëror i tregut parashtron kërkesë për nisje të procedurës për kundërvajtje në Komisionin për kundërvajtje.

Neni 70-a

Procedura kundërvajtëse për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj nuk mund të ngritët as të udhëhiqet, nëse kalojnë 18 muaj nga dita kur është kryer kundërvajtja.

Neni 70-b

Inspektori shtetëror i tregut, përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, janë të obliguar të mbajnë

evidencën për urdhërpagesat mandatore dhe urdhërpagesat për kundërvajtje e lëshuara dhe për rezultatin e procedurave të nisura.

Në evidencën e paragrafit (1) të këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës mandatore/kundërvajtëse që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi (2) i këtij neni ruhen pesë vite nga dita e futjes në evidencën.

Neni 70-v

Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës mandatore dhe për kundërvajtje e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e rregullimit të hapësirës.

Neni 70-g

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik, përkatësisht tregtarin individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 70-d

Gjobë në shumë prej 150 euro ne kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje anëtarit dhe zëvendësanëtarit në Komisionet për kategorizim dhe Komisionit për mbikëqyrje, për kryerjen e detyrës zyrtare në mënyrë të pandërgjegjshme dhe autorizim, nëse në mënyrë jo objektive është përcaktuar kategorizimi i objektit hotelerik.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

Neni 70-d 14

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga komuna, ndërsa në qytetin e Shkupit në komunën e qytetit të Shkupit, nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afat të përcaktuar në nenet 4-a paragrafi 3 dhe 4-v paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjobë në shume prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga organi kompetent shtetëror për punët nga sfera e hotelerisë, nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afat të përcaktuar në nenet 19-v paragraf 3, 21 paragrafi 3, 29 paragrafi 3 dhe 53-g paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërshtim me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga organi kompetent publik nga i cili kërkohen dëshmitë nëse nuk dorëzon dëshmitë e kërkuara në afat të përcaktuar në nenet 4-a paragraf 4, 19-v paragrafi 4, 21 paragrafi 4, 29 paragrafi 4, dhe 53-g paragraf 4i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri ne 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga komuna, ndërsa në qytetin e Shkupit ne komunën e qytetit të Shkupit, nëse nuk

vendosë sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenet 4-b paragraf 1 dhe 4-v paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Komisionit nga neni 19-b i këtij ligji, nëse nuk vendosin sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 19-b paragraf 4 i këtij ligji

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtarë të autorizuar nga organi kompetent shtetëror për punët nga sfera e hotelierisë, nëse nuk vendosë sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 22 paragraf 1 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Komisionit nga neni 28 paragrafi 1 i këtij ligji, nëse nuk vendosin sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 28 paragraf 4 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Komisionit nga neni 53-v paragrafi 1 i këtij ligji, nëse nuk vendosin sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 53-v paragraf 4 i këtij ligji.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 i këtij neni, procedura për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

Neni 70-gj

Gjobe ne shume prej 7.000 deri 15.000 euro ne kundervlere me denare, do t.i shqiptohet funksionarit, ose personit udheheqes ne Ministrine e Ekonomise, nese nuk e dergon aktvendimin nga neni 27-b paragrafi 5 te kerkuesi i kategorizimit.

Neni 70-zh 15

Gjobe ne shume prej 25 deri 50 euro ne kundervlere me denare do t.i shqiptohet per kundervajtje personit zyrtar nga organi i administrates shteterore kompetent per punet ne sferen e hotelierise nese nuk i kerkon deshmite me detyre zyrtare ne afatin e percaktuar ne nenin 27-v paragrafin 3 te ketij ligji.

Gjobe ne shume prej 25 deri 50 euro ne kundervlere me denare do t.i shqiptohet per kundervajtje personit te autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent nese nuk i dergon deshmite e kerkuara ne afatin e percaktuar ne nenin 27-v paragrafi 4 te ketij ligji.

Për kundërvajtjet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, procedurë për kundërvajtje dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente

Neni 71

I fshirë 16

Neni 72

I fshirë 17

Neni 73

I fshirë

Neni 74

I fshirë 18

Neni 75

I fshirë

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 76

Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të kryhen sipas dispozitave nga Ligji për hotelieri dhe veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/95, 33/2000, 25/2002 dhe 38/2003).

Neni 77

Hotelierët dhe personat fizik janë të obliguar ta harmonizojnë punën e tyre sipas dispozitave të këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat nga paragrafi 1 të këtij neni nuk ka të bëjë me hotelierët që kanë marrë licencë deri në kohëzgjatjen e së njëjtës.

Neni 78

Rregullat e parapara sipas dispozitave të këtij ligji do të nxirren në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 79

Deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore të parapara me këtë ligj do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 80

Me ditën e zbatimit të këtij ligji, prefekti i komunës, e në qytetin e Shkupit prefekti i komunës së rajonit të qytetit të Shkupit, do ta ndërmerr punëtorin nga njësia rajonale e organit të drejtorisë shtetërore kompetente për punët e sferës së hotelierisë që ka punuar në udhëheqjen e regjistrit për veprimtarinë turistike-hotelierë dhe udhëheqjen e evidencës të parapara me dispozitat e këtij ligji nga zbatimi i këtij ligji.

Neni 81

Me ditën e zbatimit të këtij ligji pushojnë të vlejnjë dispozitat që kanë të bëjnë me veprimtarinë hotelierë të Ligjit për veprimtari hotelierë dhe turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/95, 33/2000, 25/2002 dhe 38/2003).

Neni 82

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga dita e konstituimit

të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektëve të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004).

DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 115/2010):

Neni 9

Inspektorati Shtetëror i Tregut procedurën për barazim dhe procedurën për kundërvajtje, i udhëheq në pajtim me Ligjin për Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe Ligjin për kundërvajtje.

Neni 10

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2011):

Neni 17

Dispozitat e nenit 3 të këtij ligji me të cilin shtohen dy nene të reja 21-a dhe 21-b, nenit 5 të këtij ligji me të cilin shtohet neni i ri 22-a dhe nenit 7 të këtij ligji me të cilin ndryshohet paragrafi 6 i nenit 28, do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Dispozitat e neneve 12 dhe 13 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 141/2012):

Neni 14

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 164/2013):

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.

Ligj për plotësimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/2014):

Neni 3

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të

miratohen në afat prej 30 ditësh prej ditës së hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Ligj për plotësimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/2014):

Neni 4

Dispozitat e nenit 47-a të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej 30 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

Neni 8

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet më së voni në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2016):

Neni 8

Objektet hotelerike për akomodim nga neni 27 paragrafi 1 të këtij Ligji obligohen që të kategorizohen nga ana e Komisionit për kategorizim nga neni 27-a të këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 9

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2016):

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2016):

Neni 11

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të mbarojnë në pajtim me ligjin me të cilat ishin të filluara.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2016):

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2016):

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".